STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 16 maj 2013

MTA JEP AZHORNIMIN MBI PERPJEKJET E RIMEKEMBJES DHE RINDERTIMIT PAS SUPER STUHISE SENDI (SANDY)

Treni "A" në linjën Rokëuej (Rockaway) rifillon shërbimin më 30 maj

Seksioni i ri i përkushtuar i MTA-së do të administrojë projekte për të ndrequr dhe fortifikuar sistemin

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot disa iniciativa të Autoritetit të Transportit Metropolitan (Metropolitan Transportation Authority) (MTA) për të ndrequr përgjithëmonë dëmin nga super stuhia Sendi (Sandy), për të mbrojtur nga përmbytjet pjesë kryesore të sistemit të metrosë së Qytetit të Nju Jorkut (New York City) dhe për të filluar procesin e planifikimit për të fortifikuar rrjetin e tranzitit masiv të rajonit.

Guvernatori Kuomo (Cuomo) njoftoi gjithashtu se shërbimi në linjë Rokëuej (Rcokaway) të dëmtuar nga stuhia të trenit A do të rifillojë më 30 maj, pasi një përpjekje të përgjithshme, gjashtë-mujore të MTA-së për të rindërtuar 1,500 këmbë të shinave që i kishte marë uji, për të zëvendësuar milje të kabllove të sinjalit, korrentit e komunikacioneve dhe për të rindrequr dy stacione që u përmbytën plotësisht. Puna e re përfshiu instalimin e një muri prej fletë çeliku të përthyera që i rezistojnë ujit 30 këmbë në dheun e butë prej mbi dy milje të kalimit përgjatë Xhamejka Bei (Jamaica Bay) për të mbrojtur shinat ndaj ujrave në të ardhme dhe për të siguruar se linja është gati për të duruar stuhi të ardhshme bregdetare.

"Super stuhia Sendi (Sandy) shkatërroi të gjithë rrjetin e MTA-së si asnjë stuhi tjetër, por MTA bëri një punë të shkëlqyeshme për rikthimin e shërbimit pas stuhisë dhe në fund të këtij muaji linja A në Rokëuejs (Rockaways) do të vihet në funksionim," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Gjashtë muajt e fundit kanë parë pastrime dhe riparime të konsiderueshme, duke çuar në rivendosjen e shpejtë të shërbimit të plotë në të gjitha mjediset, përveç atyre të goditura më rëndë. Tani duhet të përqëndrohemi në përparësinë dhe sfidën e bërjes së ndreqjeve të përhershme për t'i mbajtur metrotë të sigurta dhe të qëndrueshme për vitet e ardhshme sepse njerëzit dhe bizneset e Nju Jorkut (New York) varet në një sistem të fortë dhe të qëndrueshëm të sistemit të tranzitit masiv. Puna e vështirë e rindërtimit të sistemit për të qënë më i fortë dhe më i qëndrueshëm sapo ka filluar, por do të rindërtojmë më mirë dhe në mënyrë më të zgjuar sesa më parë."

Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut i MTA-së (MTA New York City Transit) ka krijuar gjithashtu një Seksion të Rimëkëmbjes dhe Qëndrueshmërisë pas Sendit (Sandy Recovery and Resiliency Division) të ri, të përkushtuar për nisjen, çuarjen përpara dhe administrimin e rindërtimin nga Sendi (Sandy), që do të kërkojë vite të ndërtimit dhe mbikqyrjes së kujdesshme të miliarda dollarëve në ndihmë federale. Planet do të kërkojnë mbrojtjen e stacioneve, centraleve të ajrimit, tubave nën lumë, tuneleve, shinave në nivelin rrugor, sinjaleve, mjediseve dhe kantiereve për trenat, nënstacioneve të korrentit të tërheqjes, pjesëve të çelësave të qarkut, mjediseve për autobusat, kullave të trenave dhe zonave publike. Qëllimi është që të mbrohen të gjitha pikat ku sistemi i metrosë mund të përmbytet gjatë një stuhie.

Seksioni i Rimëkëmbjes dhe Qëndrueshmërisë pas Sendit (Sandy Recovery and Resiliency Division) do të mbështetet në inxhinierë, administratorë të projektit, specialistë të blerjeve dhe personel tjetër të tij me përvojë, si dhe tek punonjësit e kontraktuesve të miratuar për të administruar përpjekjen e rindërtimit.

Seksoni ka dhënë 16 urdhëra të detyrave për gjashtë firma të kualifikuara arkitekturore dhe inxhinierike, të cilat do të hartojnë riparimet e sistemit dhe do të studjojnë praktikat më të mira të përpjekjeve për qëndrueshmërinë ndaj përmbytjeve anembanë botës, do të hetojnë sesi të mund të zbatohen ndaj sfidave të sistemit të metrosë të Qytetit të Nju Jorkut (New York City) dhe do të krijojë skica skematike për ndërtim. Duke filluar këtë verë, ata do të paraqesin të parat nga një sërë planesh për të mbrojtur stacionet e prekshme të metrosë, tunelet, kantieret e ruajtjes dhe pajisjet e tjera nga stuhitë dhe përmbytjet bregdetare të ardhshme. Firma të tjera janë duke u kontaktuar për të ndihmuar në veprimtaritë e ardhshme të skicimit dhe ndërtimit.

“Guvernatori Kuomo (Cuomo) ka vendosur një standart të fortë për të mbrojtur sistemin e metrosë të Qytetit të Nju Jorkut (New York City) dhe është i njëjti standart që presin udhëtarët dhe punonjësit tanë,” tha Drejtori Ekzekutiv i Përkohëshëm i MTA-së Tomas F. Prendergast (Thomas F. Prendergast), i cili është emëruar të shërbejë si Kryetari dhe CEO i ardhshëm i MTA-së. “Jemi duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion për të filluar shpejt këtë përpjekje, në mënyrë që jo vetëm të mund të rimëkëmbim sistemin tonë në kushtet që ishte përpara sesa të godiste Sandy (Sendi), por t’a forcojmë atë ndaj stuhive të ngjashme që presim të mbërrijnë në të ardhmen.”

Vlerësime pararpake pritet të fillojnë në korrik për të mbrojtur një sferë të gjërë të infrastrukturës së metrosë, duke përfshirë hyrjet, mbulesat e ventilatorëve, tubat e ajrimit, tunelet dhe vendet e hapjes së ashensorëve, pjesët e hyrjes në to, daljet e urgjencës, pusetat, hyrjet e shërbimit, shkallaret, dhomat e makinerive, dhomat e pompimit, linjat e ujrave të zeza, tubat e kalimit, shërbimet e korrentit, ndriçimin, sistemet e HVAC, pajisjet e mbledhjes se tarifave, hyrjet e ndërtesave dhe pajisjet e tjera të vendeve të kalimit. Projekte të caktaura përfshijnë:

- Punën për të skicuar dhe planifikuar punën e riparimit në metronë e dëmtuar nën lumë;
- Zgjerimin e dhomës së pompimit;
- Planifikimi dhe skicimi i punës për mbrojtjen nga përmbytjet në kantieret e vagonave të metrosë në Koni Ajlënd (Coney Island), 148th Street e 207th Street dhe 12 centralet e ajrimit në shumë zona të nivelit të ulët në Manhatan (Manhattan), Bruklin (Brooklyn) dhe Bronks (Bronx);

- Mbrojtjen nga përmbytja në Stacionin Seint Xhorxh (St. George Terminal) dhe Klifton Shop (Clifton Shop) të Hekurudhës së Stejtën Ajlënd (Staten Island Railway);

Urdhërat e detyrave të Klifton Shop (Clifton Shop) dhe Stacionit Seint Xhorxh (St. George Terminal) mbeten pezull, në pritje të propozimeve nga furnitorët, që do të merren së shpejti.

MTA ka rreth 250 milionë dollarë në projekte të tjera të ndreqjes dhe rimëkëmbjes nga Sendi (Sandy) në punë e sipër tashmë anembanë rrjetit të tranzitit të qytetit dhe hekurudhës së udhëtarëve. Ndërsa ndreqjet e përkohëshme e kanë mbajtur në punë shumicën e rrjetit të MTA-së, do të duhen vite për të skicuar dhe zbatuar masat e përherëshme të rimëkëmbjes.

Stacioni i metrosë i Tragetit të Jugut (South Ferry) u shkatërrua dhe do të ketë nevojë për vite të punës së riparimit, ndërsa stacioni i vjetër rrethor i Tragetit të Jugut (South Ferry) është vendosur në punë gjatë kësaj kohe. Tetë tunele të metrosë nën Lumin Lindor (East River) dhe Përroin Njutaun (Newtown Creek) u përmbytën me ujë të kripur, ashtu siç ishin disa kantierë dhe stacione të metrosë.

Hekurudha e Veriut e Metrosë e MTA-së (MTA Metro-North Railroad) dhe Hekurudha e Long Ajlënd e MTA-së (MTA Long Island Rail Road) gjithashtu pësuan dëme të konsiderueshme nga super stuhia Sendi (Sandy) dhe puna vazhdon në të dyja hekurudhat për të forcuar sistemet e tyre të shinave, sinjaleve dhe korrentit për t'u mbrojtur ndaj niveleve të larta të ujit në stuhitë e ardhshme. Urat dhe Tunelet e MTA-së (MTA Bridges and Tunnels) është duke stujduar sesi të mbrojë më mirë elementet thelbësore gjithashtu dhe është duke zëvendësuar pajisje e materiale që janë në rrezik me të madh të prishjes në tunelet Hju L. Keri (Hugh L. Carey) dhe Kuins Midtaun (Queens Midtown), të cilët u përmbytën të dy gjatë stuhisë. Përveç kësaj, Urat dhe Tunelet (Bridges and Tunnels) do të zhvillojë një studim, në përputhje me rekomandimet e Komisionit NYS 2100, për të analizuar se ç'farë nevojitet për të mbajtur të dyja urat e Rokëuej (Rockaway) në gjendjen më të lartë të ndreqjes së mirë, veçanërisht gjatë ndodhive të motit ekstrem. Urat Marin Parkuej-Xhill Hoxhis Memoriëll (Marine Parkway-Gil Hodges Memorial) dhe Kros Bei Veterëns Memoriëll (Cross Bay Veterans Memorial) u prekën rëndë të dyja nga erërat e forta gjatë uraganit Irenë (Irene) dhe super stuhisë Sendi (Sandy) dhe nga përmbytja gjatë Sendit (Sandy).

Sistemi i MTA-së pësoi një dëm të vlerësuar në 4.755 miliardë dollarë ndërsa linjat e hekurudhës dhe të metrosë, tunelet e automjeteve, stacionet e metrosë dhe pajisjet e korrentit dhe të sinjaleve u përmbytën me ujë të kripur gërryes gjatë Sendit (Sandy). Tashmë pothuajse 1.2 miliardë dollarë janë caktuar për MTA në fonde nga Administrata Federale e Tranzitit (Federal Transit Administration) (FTA) për punën e ndreqjes dhe të ndihmës pas katastrofës të filluar nga Tranziti i Qytetit të Nju Jorkut (New York City Transit), Hekurudha e Veriut e Metrosë (Metro-North Railroad), Hekurudha e Long Ajlënd (Long Island Rail Road) dhe seksione të tjera të MTA-së, si dhe 3 milionë dollarë nga Agjencia Federale e Administrimit të Emergjencave (Federal Emergency Management Agency) (FEMA) për Urat dhe Tunelet e MTA-s (MTA Bridges and Tunnels).

Projektet e tranzitit të MTA-së gjatë muajve të ardhshëm do të kualifikohen për fonde shtesë për projekte të ndreqjeve dhe restaurimit të rëndësishme, si dhe për masa të mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë nga programi i Ndihmës së Emergjencës të FTA-së (FTA's Emergency Relief). Urat dhe Tunelet e MTA-së (MTA Bridges and Tunnels) gjithashtu do të kërkojnë fonde federale shtesë nga FEMA për punën e restaurimit në shtatë urat dhe dy tunelet e saj.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418